



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 132, datë 26.11.2015

PËR

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT NR. 55, DATË 30.03.2011 “PËR
NJOHJEN E VEPRIMTARISË SË AGJENTIT TË BROKERIT TË LICENCUAR TË
LETRAVE ME VLERË”, I NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Në vendimin e Bordit nr. 55, datë 30.03.2011, “Për njohjen e veprimtarisë së agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet sipas materialit bashkëlidhur.
2. Shoqëritë të cilat në zbatim të vendimit Bordit nr. 55, datë 30.03.2011, të ndryshuar kanë marrë miratimin e Autoritetit për të vepruar si agjent i brokerit të licencuar të letrave me vlerë, duhet të përshtatin veprimtarinë e tyre me kriteret e përcaktuara në këtë vendim, brenda muajit dhjetor 2015.
3. Ngarkohet drejtoria përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Enkeleda SHEHI

1. Pas pikën 5, shtohet pika 5/1 me përmbajtje si më poshtë vijon:

“5/1. Agjenti i brokerit të licencuar të letrave me vlerë në njoftimet publike apo reklamën e publikuar në mjetet e komunikimit në masë dhe në mjetet e komunikimit elektronik duhet të deklarojë dukshëm rrezikun që mbart tregtimi në platformën online. Teksti i njoftimeve publike apo të reklamave në lidhje me rrezikun përpara se të publikohen, depozitohen në Autoritet. Nëse Autoriteti brenda tre ditëve pune nga paraqitja e tekstit të njoftimit apo reklamës nuk e ndalon zyrtarisht publikimin, agjenti e publikon atë.”

2. Në pikën 7, emërtimi i strukturës “Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit” zëvendësohet me emërtimin “Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Ndërmjetësve”.

3. Përmbajtja e pikës 8, ndryshon si më poshtë vijon:

“8. Shoqëria që kryen veprimtarinë e agjentit të brokerit të licencuar të letrave me vlerë raporton çdo 3-muaj në AMF mbi veprimtarinë e kryer, sipas formatit bashkangjitur këtij Vendimi.”.

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE****Adresa: Rruga "Dora D'istria" Nr. 10,****P.O.Box 8363, Tiranë, Albania,****Tel: + 355 - (0) - 4 - 2251355/6,****Faks: + 355 - (0) - 4 - 2250686****FORMULAR RAPORTIMI****MBI****VEPRIMTARINË E AGJENTIT TË BROKERIT TË LICENCUAR TË LETRAVE
ME VLERË**

Emri i agjentit të miratuar.....

NIPT i regjistrimit në QKR.....

Shoqëria e Brokerimit për të cilën punon.....

Periudha e raportimit

I. Të dhëna për investitorët

Nr. i investitorëve sipas kategorive	Në fillim të periudhës raportuese	Të rinj në periudhën raportuese	Të larguar në periudhën raportuese	Totali në fund të periudhës raportuese
Nr. i investitorëve individualë				
Nr. i investitorëve Institucional (institucione financiare)				
Nr. i investitorëve persona të tjerë juridikë				

II. Aktiviteti i kryer

	Në fillim të periudhës raportuese	Në periudhën raportuese	Tërheqjet në periudhën raportuese	Totali në fund të periudhës raportuese
Shuma e Depozituar				
Lekë				
EURO				
USD				
Të tjera				

	Në fillim të periudhës raportuese	Në periudhën raportuese	Totali në fund të periudhës raportuese
Shuma e Tregtuar			
Lekë			
EURO			
USD			
Të tjera			
Nr. i transaksioneve			
Lekë			
EURO			
USD			
Të tjera			

III. Të ardhurat nga komisionet

Të ardhurat e agentit nga komisionet	Në fillim të periudhës raportuese	Në periudhën raportuese	Totali në fund të periudhës raportuese
Lekë			
EURO			
USD			
Të tjera			

Nënshkrimi i Personit të Autorizuar

Data e plotësimit _____

Shënime:

- 1. Ky formular plotësohet çdo 3-muaj. Agjenti i miratuar detyrohet që të dorëzojë në AMF formularin e plotësuar brenda datës 5 të muajit pasardhës, sipas periudhave respektive.*
- 2. Të dhënat progresive jepen për çdo vit kalendarik.*
- 3. Një transaksion nënkupton mbylljen e një pozicioni të hapur në platformë.*
- 4. Formulari plotësohet në excel.*